

Muzeu i Artit Mesjetar: “Ringjallja e Llazarit”



“Ringjallja e Llazarit”, një nga kryeveprat e Kontandin Zografit, e realizuar në vitin 1770, ku në ato kohë zbukuronte Kishën e Mitropolisë në Korçë, tashmë, prej një viti zbukuron në mënyrë dinjitoze, një nga ambientet e UNESCO-s, midis shumë kryeveprash të tjera nga e gjithë bota.

Kjo vepër përveç se paraqet mrekullinë e saj biblike, shfaq edhe mrekullinë e ngjyrave, kompozimit, vlerave të artit figurativ.

Në këtë kohë të vështirë, më shumë se domethënëse, ikona simbolizon, forcën e njeriut, ringritjen dhe dashurinë për jetën, duke sjellë kështu mesazhin më optimist, atë të shpresës.